

V E N D I M
Nr. 48, datë 2.6.2001

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT “TOP CHANNEL”

Në mbështetje të ligjit nr.8410,datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8655, datë 31.7.2000, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televisionit

V E N D O S I:

1. T’i japë subjektit, shoqërisë “TOP CHANNEL” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Licenca, bashkëlidhur, përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Sefedin Çela